



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1844 prot.

Pukë, më 02.09.2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 05 Datë 02.09.2022

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. Mark Ukshin Dedaj (pas vdekjes)

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të nenit 54, pika "m" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika "ç"; të ligjit nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 113, pika "dh", të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **z. Mark Ukshin Dedaj (pas vdekjes)** me motivacionin:

"Për merita të shquara të fisnikërisë, të trimërisë me armë në dore për çlirimin e vendit, të atdhetarisë, të patriotizmit, të qëndresës në mbrojtjen e traditave të vendit të tij, të sakrificës deri në aktin sublim të dhënieve së jetës për mbrojtjen e pasurisë së popullit të berishajve si dhe në kontributin e dhënë në fushen kulturor-artisitike".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, i ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Ne mungese dhe më urdher

Zv.kryetari
Kristjan Marku

Jurist
Endrit Kraja

K R Y E T A R I
Gjon Gjonaj



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Relacion

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI”

Z. Mark Ukshin Dedaj (pas vdekjes)

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin **112/2013**, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, datë **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhëni e titullit qytetar nderi **z. Mark Ukshin Dedaj (pas vdekjes)** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij, Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin, ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të vlerësohet figura tij dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjojje publike për të gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në fushën e atdhetarizmit. I lindur në fshatin Belshina, Berishë e Vogël, më 03.09.1923. Lindur në një familje patriotike si udhëheqëse e çetave qëndrestare të berishajve si familje me dy dëshmorë. Mësimet e para i mori në oden fetare të prifit të Berishës. Që në rini ju bashkua lëvizjes Nacional-Çlirimtare i inkuadruar në Brigaden 27 Sulmuese për çlirimin e vendit. Ai u bë pjesë dhe e grupeve artistike të zonës së Iballës.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

T'i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë, **z. Mark Ukshin Dedaj (pas vdekjes)** me motivacionin:

“ Për merita të shquara të fisnikërisë, të trimërisë me armë në dore për çlirimin e vendit, të atdhetarisë, të patriotizmit, të qëndresës në mbrojtjen e traditave të vendit të tij, të sakrificës deri në aktin sublim të dhënieve së jetës për mbrojtjen e pasurisë së popullit të berishajve si dhe në kontributin e dhënë në fushen kulturoro-artisitike” .

Ky titull i jepet në shenjë nderimi dhe vleresimi për të gjithë punën dhe kontributin e dhënë në fushën e atdhetarizmit, **z. Mark Ukshin Dedaj (pas vdekjes)**.

1. Për të gjitha meritat e lartpërmendura propozohet ti akordohet titulli “Qytetar Nderi i Bashkise Pukë”.

**Drejtor Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Emirjona Pergjegjaj**

C.V- VITAE E MARK UKSHIN DEDËS

U lind në fshatin Belshina, Berishë-Vogel, Pukë, më 16.3.1923, në trungun e familës së madhe Deda, një familje patriotike, luftëtare dhe qëndrestare, e njohur ndër pukjan dhe Shqipëri për qëndresen dhe trimëritë, si udhëheqëse e Çetave qëndrestare të berishajve, dhe si familje me dy dëshmorë të Atdheut.

I lindur e rritur në këtë familje ai përvetësoj cilësitë më të mira të parve si fisnikëria atdhetaria, trimëria, qëndresa dhe sakrifica. Të gjitha këto virtute ai i manifestoj duke mbajtur veten dhe familjen larg së keqes, së ligës, larg smirës. Mësimet e para i mori në oden fetare të priftit të Berishës, dije jo vetëm fetare por edhe të gjuhës shqipe, historisë, gjeografisë dhe veprimeve matematikore. Për Markun, kjo ishte ditë e re drejt dijes si akt që do ta mburste atë me dije të gjera. Ajo që e tërhoiqte më shumë ishin mësimet e letersisë nepërmes të cilave arrin të lexoje shumë vepra të shkrimtarve tanë. Kishte diejni edhe të gjuhës italiane.

Në moshen e rinisë u lidh me lëvizjen Nacional-Çlirimtare, i inkadruar në Brigaten e 27 Sulmuese për çlirimin e vendit. Në vitet pas çlirimtimit dha kontribut të vyer për problemet shoqërore të zonës. Në kushtet e jetes në fshat ai kishte dhuni të ushtruarit me pemtari. Një profesion të vetin kishte artin, ndaj mësoj dhe ti bjerë çiftelise dhe të këndojë. Në rrugëtimin e vet në fushën kulturore ai u be pjesë e grupeve artistike të fshatit dhe të zonës së Iballës. Në këtë menyrë popullariteti i tij u rritë shumë.

Në vitet pas çlirimtimit jep kontributin e vet për probleme shtetërore nen armën e forcave të armatosura edhe jashtë territorit pukjan deri në Malësi të Madhe. Për merita të tij u emërua komandant poste i policisë në Koplik dhe ku qëndroj për disa kohë. Në vitin 1946 ai kalon në ushtri me pagesë më graden rreshter. Pas 5 muash transferohet më punë në Gjirokastër. Për merita në detyrë ai merr graden nentoger.

Marku kaloj sakrifica të mëdha duke u burgosur padrejtësisht, politikisht, dhe bëri 15 vite burg. Më pas punoj në kooperativën e Berishës bashkë me bashkëshorten. Në vitin 1985 ai humbi jeten nga vërvshimi i liqenit të Fierzës, në përpjekje për të mbrojtur pasurinë e kooperativës. La pas vlerat dhe kontributet e tij të cilat u bënë akte frymëzimi për familjen, bijt e tij dhe shoqërinë në tërsi. **Grupi Nismëtar**

PROPOZIM

PËR DHENJE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË, TË NDJERIT MARK UKSHIN DEDA PAS VDEKJES.

z. Gjon Gjonaj – KRYETAR I BASHKISË

PUKË

NË VEMENDJE: KËSHILLIT BASHKIAK BASHKIA

PUKË

I nderuar Kryetar!

Të nderuar Anëtar të Këshillit Bashkiak, Bashkia PUKË

Nisur nga sakrificat, kontributi, dhe qëndresat e Mark Ukshin Dedës, sakrifica me armë në dorë i inkuadruar në formacionet e Brigatës së 27-të Salmuese, më tej për kontribut në problemet shoqërore dhe ato të detyrave në armën e policisë dhe ushtrisë, si dhe vuajtjeve në burgjet shqiptare si i burgosur politik për 15-vjet, i cili edhe pas daljes nga burgu dha plot impulse pozitive në shoqërinë berishase dhe atë pukjane, duke u bërë shëmbull i fisnikërisë, atdhetarisë, dhe i patriotizmit, cilësi që quan në aktin e fundit të dhenjes së jetës për të shpëtuar pasurinë e popullit të berishajve, dhe për të gjitha këto propozojmë që Mark Ukshin Dedës t'i jepet titulli:

QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË, PAS VDEKJES, ME KËTË MOTIVACION

“ Për merita të shquara të fisnikërisë, të trimërisë me armë në dorë për çlirimin e vendit, merita të atdhetarisë, të patriotizmit, të qëndresës në mbrotjen e traditave të vendit të tij, të sakrificës deri në aktin sublim të dhenjes së jetës për mbrojtjen e pasurisë së popullit të berishajve, si dhe në kontributin e dhenë në fushen kulturoro - artistike, për edukimin e bijve të tij sa ishte gjallë, dhe më pas me vlerat që la pas” .

Grupi Nismëtar

Sulejman Sula

Pashk Alia

Gjergj Ndou

Zef Prendi

Mark Gjoka

Ndoc Prendi

Pjetër Pjetri

Gjergj Deda

Visar Alia